Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Kuvendi i Komunës Rahovec*

*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

# PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR DRAFT STATUTIN E ANSAMBLIT KOMUNAL TË KËNGËVE DHE TË VALLEVE NË RAHOVEC


REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS ... MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 964 Nr. i faq/Br.str/No.pg 193
Data/Datum/Date 7 / 7 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT STATUTIN E ANSAMBLIT KOMUNAL TË KËNGËVE DHE TË VALLEVE NË RAHOVEC

## INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Komuna e Rahovecit, respektivisht grupi punues për përgatitjen e Projekt- Statutit të Ansamblit Komunal të Këngëve dhe të Valleve në Rahovec, duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe Nenit 7, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizon:

KONSULTIM PUBLIK
Lidhur me Draft Statutin për Projekt-Statutin e Ansamblit Komunal të Këngëve dhe të Valleve në Rahovec

Njoftimi për organizimin e konsultimit publik për Projekt Statutin e Ansamblit Komunal të Këngëve dhe të valleve në Rahovec u publikua me datë: 20.6.2023 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/Njotim-per-konsultim-publik-per-Projekt-Statutin-e-Ansamblit-Komunal.pdf në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna .

**Njoftimi përveç që është publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimi është dërguar edhe përmes rrjeteve sociale Viber.**

- **Më datë 20/6/2023**, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik për : **"Draft Statutin e Ansamblit Komunal të Këngëve dhe të Valleve në Rahovec"**, njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës në këtë vegëz: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/Njotim-per-konsultim-publik-per-Projekt-Statutin-e-Ansamblit-Komunal.pdf ,Projekt Statuti i Ansamblit Komunal të Këngëve dhe të Valleve në Rahovec është publikuar në këtë vegëz: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/DRAFT-STATUTI-I-ANSAMBLIT-TE-KOMUNES-SE-RAHOVECIT.doc

Njoftimi dhe dokumenti janë publikuar edhe në Platformën e Konsultimeve Publike në këtë vegëza: https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41924

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT STATUTIN E ANSAMBLIT KOMUNAL TË KËNGËVE DHE TË VALLEVE NË RAHOVEC

## KONSULTIMI PUBLIK

Më datë: **3/7/2023** mbahet konsultimi publik në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, përfaqësues të OJQ-ve që veprojnë në komunën e Rahovecit.

Dokumenti i Projekt Statutin e Ansamblit Komunal të Këngëve dhe të valleve në Rahovec është në konsultim publik nga data: **20.6.2023** deri më: **20.7.2023**.

Numri i pjesëmarrësve në konsultim ishte:11

Numri i femrave pjesëmarrëse ishte: 8

Dëshmi janë listat e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në konsultim.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën: https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/u-mbajt-konsultimi-publik-per-draft-statutin-e-ansamblit-komunal-te-kengeve-dhe-valleve-ne-rahovec/

Konsultimi publik filloi në orën 14:00.

Konsultimin e shpalli të hapur drejtori i DKRS, z.Afrim Dina.

**Afrim Dina,** *drejtori i DKRS:* Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, jemi në konsultimin për draft-Statutin e Ansamblit Komunal të Këngëve dhe të Valleve në Rahovec. Me datë: 4.4.2023 është caktuar Grupi Punues nga Kryetari, ku deri më tani i kemi mbajtur 3 takime.

Pas konsultimit, grupi punues do të mblidheT edhe dy ose tri herë deri në miratimin e Statutit.

Para pjesëmarrësve në konsultim e prezantoi në pika të shkurtëra draft-Statutin e Ansamblit Komunal të Këngëve dhe të Valleve në Rahovec.

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT STATUTIN E ANSAMBLIT KOMUNAL TË KËNGËVE DHE TË VALLEVE NË RAHOVEC

## PYETJET, KOMENTET DHE SYGJERIMET E QYTETARËVE:

**Naser Dula**, drejtor i Shkollës së muzikës ''Vihuela'': Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, iniciativë shumë e mirë që është bë Draft-Statuti, ka qenë nevojë e kahershme që Rahoveci ta ketë Ansamblin, i cili njihet si qytet i lashtë i kulturës dhe artit. Mendojë që ky ansambël do ta fuqizojë pjesën rekreative të qytetit.

**Baki Xhaferi**, qytetarë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ide shumë e qëlluar jo vetëm për qytetin por edhe për fshatrat.

- Si do të jetë orkestra?
- Sa anëtar parashihet ti ketë Ansambli?

**Fatmir Sejfullahu**, SHKA ''Bajram Curri'', Krushë e Madhe: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

- A keni ndojnë pikësynim për themelimin e Ansamblit, apo vetëm si Statut.

**Emir Mullavda**: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

Ka ardhur koha që të punohet!

**Qemajl Krasniqi**, Zyrtar i DKRS-së: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

Kemi shqyrtuar disa modele të statuteve të komunave tjera, për fat të mire Rahoveci e ka një trashëgimi të pasur kulturore.

Ne e kemi vetëm një shoqëri funksionale atë të Krushës së Madhe.

Në hartimin e këtij Statuti ne ju kemi referuar Statutit të ansamblit Shota më shumë. Nuk do të ketë vetëm folklorë por të gjitha vlerat kulturore-artistike.

Nga sot e deri më datën 20 korrik mund të jepni mendimet, vërejtjet, sygjerimet dhe opinionet.

**Muharem Morina**, zyrtar i DKRS-së: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT STATUTIN E ANSAMBLIT KOMUNAL TË KËNGËVE DHE TË VALLEVE NË RAHOVEC

Diapazoni i një ansambli është goxha i gjerë, parashihet sektori i orkestrës, folklorit, valleve dhe të këngëve.

**Afrim Dina,** Drejtor i DKRS-së: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

Jemi në fazën e parë, pra në themelimin e ansamblit, pastaj fazat tjera. Këto janë procedura ligjore në të cilat duhet të kaloj themelimin i draft-statutit. Në fazën tjetër do të zgjidhen trupat artistikë.

Ju bëj thirrje të gjithë qytetarëve ti japin mendimet, sygjerimet, vërejtjet dhe plotësimet rreth këtij draft-Statuti.

Konsultimi publik përfundoi në orën: 14:43

## Dëshmi nga konsultimi-Fotografitë





PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT STATUTIN E ANSAMBLIT KOMUNAL TË KËNGËVE DHE TË VALLEVE NË RAHOVEC







## PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKT STATUTIN E ANSAMBLIT KOMUNAL TË KËNGËVE DHE TË VALLEVE NË RAHOVEC

### Listat e nënshkrimeve





Dokumentin e përgatiti:

Qëndresa Duraku

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

7.7.2023, Rahovec